



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:056553

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05472843

PPP.nr.1674/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, si dhe me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.a., me seli në Prishtinë, rr.Bill Klinton, kundër debitorit H.K nga Prishtina, rr. “.....” p.nr., lidhur me çështjen përmbarimore pagesë e borxhit, vlera 89.30€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.3140/2018, të datës 23.10.2018, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka nga Prishtina, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht i bazuar prapësimi i debitorit H.K nga Prishtina, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht urdhëri përmbarimor P.nr.3140/2018, i datës 23.10.2018 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Valdin Beka në Prishtinë dhe atë për periudhën kohore nga data 29.09.2016 deri me datë 27.12.2016, në shumë prej 32.90€.
- II. REFUZOHET prapësimi i debitorit H.K, ashtu që Urdhëri Përmbarimor P.nr.3140/2018, i datës 23.10.2018 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Valdin Beka, MBETET në fuqi për periudhën kohore nga data 30.01.2017 deri me datë 31.12.2017, për shumën e borxhit 56.40€, deri në përmbushjen përfundimtare të detyrimit.
- III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës, ta paguaj garancionin në xhirollogarinë e kësaj gjykate në shumën prej 56.40€ (Euro).
- IV. Në rast se debitori dështon të paguaj shumën e lartcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Përmbaruesi privat Valdrin Beka, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhëri me të cilin ka lejuar përmbarimit në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist në emër të debitorit H.K për periudhën 29.09.2016 deri me datë 31.12.2017, me të cilin ka kërkuar që debitorit të obligohet t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 89.30€, të gjitha detyrimet të përmbushen përmes bllokimit të llogarisë bankare apo regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme të debitorit dhe përmes shitjes së tyre deri në vlerën e borxhit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke e konstatuar në tërsi propozimin për përmbarim për arsyeje se nuk ka legjitimitet pasiv për të përmbushur ndonjë detyrim ndaj kreditorit sepse nuk ka bazë për ekzistimin e ndonjë borxhi të krijuar ndaj kreditorit sepse nuk është krijuar ndonjë raport me detyrim të dyanshëm përmes lidhjes së ndonjë kontrate. Tutje ka shtuar se në mungesë të një kontrate, nuk ka pas asnjëherë faturim në emër të debitorit dhe fatura për shërbim të mbeturinave nuk i janë dorëzuar kurr debitorit mirëpo të njëjtat vetëm janë sajuar nga kreditori dhe të njëjtat nuk paraqes titull përmbarimor në bazë të dokumentit të besueshëm sipas dispozitave të LPP-së. Duke shtuar se në këtë lëndë kemi të bëjmë me urdhër detyrues nga kreditori që daton nga viti 2014 deri 2017 i njëjti është i parashkruar në kuptim të nenit 360 të LMD-së sepse propozimi për përmbarim është paraqitur me datë 22.10.2018, i ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi.

Kreditorja ka paraqitur përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor. Lidhur me pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, kreditorja ka theksuar se ekstraktet e verifikuara nga librat afarist paraqesin dokument të besueshëm konform dispozitës së nenit 29 par.1, pika 1.2 të LPP-së. Tutje ka theksuar se kreditorja është e vetmja ndërmarrje publike në regjionin e Prishtinës, e licencuar për kryerjen e shërbimeve të pastërtisë dhe higjenës publike, ku e mbulon Prishtinën, Fushë Kosovën, Obiliqin, Lipjanin, Podujevën, Drenasin, si dhe Graçanicën. Ka theksuar se baza juridike për faturim mbi shërbimet e kryera është e bazuar në dispozitat e aplikueshme ligjore dhe tarifata zyrtare. Ka shtuar se me rregulloren për shërbime publike komunale të aprovuara nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, nr.01-352-1934, dt.28.07.2010, janë paraparë obligimet, autorizimet dhe kushtet për të gjithë subjektët rreth mirëmbajtjes së higjenës publike në qytet. Nga këto arsye ka propozuar që prapësimi të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas studimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata ka vlerësuar dokumentin e besueshëm – ekstraktin e verifikuar nga librat afarist 97644, dt.17.10.2018, në emër të H.K , për periudhën 29.06.2016 deri 31.12.2017, në bazë të së cilës organi përmbarues ka zbatuar përmbarimin dhe ka vlerësuar se i njëjti paraqet dokumente të besueshëm dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1 pika 1.2 dhe par.3 e lidhur me nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe pas analizimit të këtyre pretendimeve në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit.

Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 360 paragraf 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për*

mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.

Kurse me nenin 368 paragraf 1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077) përcaktohet se: “*Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.* Po ashtu edhe me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: “*Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton se, kërkesat për furnizim me shërbimet e pastrimit parashkruhen brenda afatit prej një viti, ndërsa afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin kërkesa arrin për pagesë. Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim, se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2 të LMD-së. Kreditori ka kërkuar përmbarimin e borxhit për periudhën nga data 29.09.2016 deri me datë 31.12.2017, ndërsa propozimin për përmbarim e ka paraqitur me datë 22.10.2018. Bazuar në këtë, rezulton se borxhi i kreditorit është pjesërisht i parashkruar, dhe atë për periudhën 29.09.2016 deri me datë 27.12.2016 kjo për faktin se nga dita kur janë bërë të arritshme kërkesat periodike për këtë periudhë, e deri në ditën kur është paraqitur propozimi për përmbarim, për të gjitha kërkesat prej datës 29.09.2016 deri me datë 27.12.2016 ka kaluar më shumë se një vit, andaj gjykata konstaton se në rastin konkret lidhur me periudhën kohore të cekur si më lartë kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, kjo për faktin se ka kaluar koha e paraparë me ligj brenda të cilit kreditori mund të kërkojë përmbarimin e detyrueshëm të kërkesës së tij karshi debitorit.

Deri tek shuma prej 56.40€ për të cilën propozimi për përmbarim është lënë në fuqi, gjykata erdhi për faktin se kërkesa e përgjithshme e kreditorit është 89.30€ dhe nga llogaritja e faturimeve për periudhën 29.09.2016 deri me 27.12.2016 për të cilën ka parashkrim të kërkesës rezulton shuma prej 32.90€, e cila kur zbritet nga shuma e përgjithshme 89.30€, del shuma prej 56.40€ për periudhën 30.01.2017 deri me 31.12.2017 periudhë kjo për të cilën nuk ka parashkrim të kërkesës, në shumë prej 56.40€ dhe për të cilën urdhëri përmbarimor P.nr.3140/18 i dt.23.10.2018 mbetet në fuqi.

Në momentin e vendosjes, gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e debitorit lidhur me atë se në periudhën për të cilën kërkohet borxhi kreditorja nuk i ka kryer shërbimet për shkak se shtëpia e debitorit është larg dhe debitori nuk mund të ketë qasje për marrjen e mbeturinave, mirëpo gjykata këto pretendime i vlerëson të pabazuara për faktin se procedura përmbarimore është procedurë e karakterit rigoroz-formale në të cilën bëhet realizimi i drejtpërdrejtë i të drejtave të njohura në bazë të titullit ekzekutiv në këtë rast dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit, duke u kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit të besueshëm e që në rastin konkret ka qenë ekstrakti nga librat afarist 97644, dt.17.10.2018.

Gjykata vlerëson se pjesërisht janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitje të prapësimit në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore ku si shkak për paraqitje të prapësimit parashihet: “*Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: . ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi”, e që në*

rastin konkret të çështjes juridike në fjalë është vërtetuar se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së kreditores.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin vendosi që ta aprovoj pjesërisht në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore dhe vendosi si në pikën I, kurse pjesën tjetër të prapësimin e refuzoj si të pabazuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi debitorin që në rast të parashtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 56.40€, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e paralajmëroi debitorin se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
PPP.nr.1674/2018, dt.19.03.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.